



UNOSEK

United Nations Office of the Special Envoy of the Secretary-General for the Future Status Process for Kosovo

Press Release

www.unosek.org

UNOSEK/PR/13

E martë, 8 gusht 2006

Beogradi e Prishtina e mbajtën takimin për të drejtat e komuniteteve

Vjenë – Delegacionet nga Beogradi dhe Prishtina, sot, e mbajtën takimin e parë të bisedimeve të drejtpërdrejta për të drejtat e komuniteteve në Kosovë nën mbikëqyrjen e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisaari.

Takimi filloi me paraqitjet e qëndrimeve të tyre nga palët lidhur me parimet për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, para se të kalonin në diskutime më të hollësishme për përfaqësimin e komuniteteve nëpër institucione, mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, si dhe të fushave kryesore të të drejtave të komuniteteve, si të drejtat e gjuhës, mediat dhe liria e lëvizjes.

“Qëndrimet e palëve ishin konceptualisht shumë larg njëra tjetrës”, u tha gazetarëve më pas Bernhard Schlagheck, këshilltar i lartë i UNOSEK-ut, i cili e kryesoi takimin e sotëm. “Delegacioni i Prishtinës, aktualisht, ka bërë propozime konkrete për të drejtat e komuniteteve, delegacioni i Beogradit i ka paraqitur pikëpamjet e veta duke thënë se të drejtat e komuniteteve në Kosovë duhet të trajtohen në kuadrin e bisedimeve për statusin, pa dalë kështu me ndonjë propozim konkret.”

Z. Schlagheck vazhdoi duke thënë se UNOSEK-u e ka për qëllim që të vazhdojë të angazhohet me palët lidhur me këtë çështje nëpërmjet bisedave të nivelit të ekspertëve me fokus në propozimet e hollësishme dhe praktike.

Duke iu përgjigjur pyetjes së një gazetari lidhur me mospjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në këtë takim, z. Schlagheck shprehu keqardhjen e tij, duke thënë se, përderisa ishte në duart e tyre marrja e këtij vendimi, “ky vendim është një mundësi e lëshuar për t’u angazhuar në një proces i cili ka rëndësi shumë të madhe për të gjitha komunitetet e Kosovës, e jo më pak për komunitetin serb”.

Para takimit, i dërguari i posaçëm Martti Ahtisaari është takuar ndaras me të dyja delegacionet. Ai e përshëndeti vendimin e të dyja palëve për t’u angazhuar në bisedimet për të drejtat e komuniteteve: “Këto janë shumë të rëndësishme për ardhmërinë e Kosovës”, tha ai, duke shtuar: “qëllimi ynë është që t’i krijojmë kushtet për një Kosovë e cila vërtetë është shumëetnike dhe në të cilën të drejtat e komuniteteve do të respektohen dhe promovohen në tërësi”.